

Këshilli Kombëtar i BSPSH-së është organi vendimor i BSPSH, i cili drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e tij në zbatim të detyrave të Kongresit dhe të Asambles[Kombëtare të BSPSH.

Ai përbëhet nga:

Presidenti dhe Zv/Presidenti.

Kryetarët e federatave, Kryetarët e sindikatave të Qarkut (Prefekturës).

Sekretariati, Përfaqësuesja e Forumit të Gruas dhe të Rinisë, Kryetari i Komisionit të Revizionimit.

Në mbledhje të Këshillit Kombëtar për probleme të ndryshme, Presidenti fton të marrin pjesë specialistë nga personeli administrativ i BSPSH.

Këshilli Kombëtar drejtohet personalisht nga Presidenti e në mungesë të tij nga Zv/ Presidenti.

Përbërja e Këshillit Kombëtar miratohet nga Asambleja Kombëtare e BSPSH-së.

Këshilli Kombëtar zakonisht mbledhet jo më pak se tri herë në vit. Ai mund të thirret jashtë radhe me kërkesë të Presidentit ose me 50% + 1 të anëtarëve të Këshillit Kombëtar.